





EUROPEAN CENTRAL BANK

EUROSISTEMI



BANKA QENDRORE EVROPIANE  
EUROSISTEMI  
SISTEMI EVROPIAN I BANKAVE  
QENDRORE



# PËRMBAJTJA



Parathënie	2-3
1. Rruga drejt Bashkimit Ekonomik dhe Evropian	
1.1 Integrimi evropian	4
1.2 Integrimi ekonomik	5
1.3 Kriteret e konvergjencës	6
1.4 Karakteristikat kryesore të Eurozonës	7
1.5 Përparësitë e euros	8
Momentet historike	10
2. Struktura dhe detyra	
2.1 Sistemi Evropian i Bankave Qendrore dhe Eurosistemi	12
2.2 Banka Qendrore Evropiane	12
2.3 Detyrat e Eurosistemit	13
2.4 Pavarësia	14
2.5 Bankat qendrore evropiane	16
2.6 Organet vendimmarrëse të BQE-së	16
2.7 Komitetet e SEBQ-së	19
3. Politika monetare	
3.1 Stabiliteti i çmimeve	20
3.2 Strategjia e politikës monetare të BQE-së	20
3.3 Instrumentet e politikës monetare	21
3.4 Komunikimi	23
3.5 Statistikat monetare dhe financiare	24
4. Sistemi TARGET 2	26
5. Kartëmonedhat dhe monedhat euro	
5.1 Kartëmonedhat	28
5.2 Monedhat	29
6. Mbikëqyrja bankare	30
Fjalorth	32

# PARATHËNIE



Të gjitha botimet edukative që Banka e Shqipërisë ka sjellë për publikun ndër vite, kanë synuar të ndërtojnë një sistem të plotë njohurish dhe vlerash, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm për rritjen e mirëqenies dhe përparimit shoqëror. I njëjti sistem vlerash ka shërbyer, për më shumë se gjysmë shekulli, si themel mbi të cilin janë ngritur të gjitha institucionet e bashkësisë evropiane, dhe sot na shërben si orientim në rrugën tonë drejt integritit evropian.

Në ditët e sotme, ju dëgjoni shpesh të flitet për Bankën Qendrore Evropiane, Eurozonën, Sistemin Evropian të Bankave Qendrore dhe shumë koncepte të tjera të lidhura me procesin e integritit evropian, të cilat kanë hyrë natyrshëm në fjalorin tonë. Broshura që mbani në duar do t'ju ndihmojë të zërtheni këto koncepte dhe t'i përgjigjeni shumë pyetjeve në lidhje me to. Kështu, ju do të mund të njiheni më nga afër me ngjarjet historike dhe institucionet e ndërmjetme që sollën më pas krijimin e Bankës Qendrore Evropiane, strukturën e institucioneve financiare që ndikojnë jetën e qytetarëve evropianë – por jo vetëm – me vendimet e tyre dhe mënyrën si rregullohen e bashkërendohen ato brenda një sistemi të vetëm, kompleks e shumënivëlor.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe më pas në Eurosistem nënkupton ecjen në një hap me institucionet evropiane dhe përafrimin me vlerat që ato përfaqësojnë. Sa më shpejt dhe më mirë të përvetësojmë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ngritur bashkësia evropiane, aq më shumë i afrohemi aspiratës tonë për tu bërë anëtarë të denjë e kësaj bashkësie.

Përmes shfletimit të kësaj broshure, ju ftoj të hedhim së bashku një vështrim mbi të ardhmen që aspirojmë.

Ardian Fullani

Governator i Bankës së Shqipërisë

# PARATHËNIE



Ideja e parë që të vjen ndër mend kur flitet për një “bankë qendrore”, është me siguri ajo e një institucioni që emeton paranë. Paraja është instrumenti që ne përdorim si njësi llogaritjeje, si mjet pagese dhe si ruajtës i vlerës. Dihet gjerësisht që objektivi themelor i çdo banke qendrore është të kujdeset që të ruhet vlera e parasë në kohë. Megjithatë, ka edhe disa aspekte të tjera jo aq të njohura të bankingut qendror modern, dhe një prej tyre është komunikimi. Një bankë qendrore nuk duhet vetëm të bëjë atë që deklaron, por nevojitet edhe të shpjegojë atë që është duke bërë, në këtë mënyrë rrit ndërgjegjësimin dhe njohuritë e publikut mbi politikat që harton dhe shërbimet që ofron.

Kjo broshurë publikohet në kuadër të komunikimit tonë mbi veprimtarinë e Bankës Qendrore Evropiane si epiqendra e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, së bashku me bankat qendrore të 27 shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Meqenëse, jo të gjitha shtetet anëtare kanë adoptuar monedhën Euro, termi “Eurosistem” përdoret për të përshkruar entitetin e përbërë nga Banka Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore kombëtare të 17 shteteve anëtare, të cilat kanë adoptuar deri më tash monedhën Euro. Është pikërisht Eurosistemi, ai që kryen shumicën e detyrave që Traktati i Bashkimit Evropian i njuh Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

Kjo broshurë mund të lexohet edhe në versionin elektronik, në faqen zyrtare të BQE-së ([www.ecb.europa.eu](http://www.ecb.europa.eu)). Ky version përditësohet më shpesh sesa ai në formatin e printuar.

Ju uroj lexim të këndshëm, cilido qoftë formati që keni zgjedhur për të shfletuar këtë broshurë.

Frankfurt mbi Main, janar 2011

Jean-Claude Trichet  
President i Bankës Qendrore Evropiane

# RRUGA DREJT BASHKIMIT EKONOMIK DHE MONETAR



## INTEGRIMI EVROPIAN

Ideja e bashkimit ekonomik dhe monetar në Evropë lindi rreth gjysmë shekulli më parë. Ajo ishte pjesë e vizionit të liderëve politikë, të cilët në vitin 1952 themeluan **Komunitetin Evropian të Qymyrit dhe Çelikut (KEQÇ)**, të përbërë nga gjashtë vende: Belgjika, Franca, Gjermania, Holanda, Italia dhe Luksemburgu.

### Zgjerimi gradual i Bashkimit Evropian

Gjatë viteve '50 e më tej u ndërmorën të tjerë hapa drejt integritimit evropian; kështu në 1958 gjashtë vendet e mësipërme themeluan **Komunitetin Ekonomik Evropian (KEE)** dhe Komunitetin Evropian për Energjinë Atomike (EURATOM). Këto marrëdhënie do të përforcoheshin e thelloheshin më tej në vite, si fillim nëpërmjet krijimit të Komuniteteve Evropiane (KE), për të vazhduar më pas në Bashkimin Evropian (BE), me adoptimin e Traktatit të Mاستrihtit në vitin 1993. Po kështu, do të rritej edhe numri i vendeve anëtare. Në vitin 1973, u anëtarësuan Danimarka, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar, të ndjekura nga Greqia tetë vjet më vonë. Portugalia dhe Spanja u bënë anëtarë në vitin 1986, ndërsa Austria, Finlanda dhe Suedia në 1995. Zgjerimi vazhdoi edhe më tej, kur më 1 maj 2004 u anëtarësuan Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Qipro, Republika e Çekisë, Sllovakia dhe Sllovenia. Ndërkohë, Bullgaria dhe Rumania, anëtarët më të rinj të BE-së aderuan më 1 janar 2007.

### Kriteret e anëtarësimit në BE

Vendet kandidatë që aplikojnë për anëtarësim në BE duhet të përmbushin disa kushte që njihen si **kriteret e Kopenhagenit**. Këto kriteret kërkojnë nga vendet që të sigurojnë (i) institucione të qëndrueshme të cilat të garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, si dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve dhe (ii) një ekonomi tregu funksionale, si dhe aftësinë për të përballuar presionet konkurruese, në mënyrë që të mund të përmbushin detyrimet e anëtarësimit, përfshir këtu edhe objektivat e bashkimit politik, ekonomik dhe monetar.



Referojuni fjalorthit



Rruga drejt Bashkimit  
Ekonomik dhe Monetar

1.1 Integrimi evropian  
1.2 Integrimi ekonomik  
1.3 Kriteret e konvergjencës

1.4 Karakteristikat kryesore të Eurozonës  
1.5 Përfitimet nga euro

Momentet historike



Struktura dhe detyrat



Politika monetare



Sistemi TARGET 2





Kartëmonedhat dhe  
monedhat Euro







Mbikëqyrja bankare


## 1.2 INTEGRIMI EKONOMIK

Përplekja e parë për të skicuar rrugëtimin e një bashkimi ekonomik dhe monetar në tre faza për një periudhë dhjetëvjeçare, zë fill në vitin 1970 me Raportin Werner<sup>1</sup>. Megjithatë, ky projekt fillestar nuk arriti të realizohej si rrjedhojë e tensioneve të forta që përshkuan tregjet ndërkombëtare të këmbimit valutor pas rënies së sistemit të Bretton Woods në fillimvitet '70, si dhe të recesionit ekonomik të shkaktuar nga kriza e naftës në vitin 1973.

Për t'i bërë ballë kësaj situatë të brishtë e të paqëndrueshme, nëntë shtetet anëtare të KEE-së krijuan në vitin 1979 **Sistemin Monetar Evropian (SME)** , në thelb të të cilit ishte **mekanizmi i kursit të këmbimit (MKK)** . Ky mekanizëm parashikonte për monedhat e këtyre nëntë vendeve, përcaktimin e një regjimi të kursit të këmbimit fiks, por të rregullueshëm.

Idea e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar do të rilindte me Aktin Unik Evropian në vitin 1986, i cili krijoi një treg të përbashkët. Ky moment historik solli edhe bindjen se përfitimet e plota të tregut të përbashkët mund të korreshin vetëm nëse vendet pjesëmarrëse do të përdornin një monedhë të vetme. Në vitin 1988, **Këshilli Evropian**  ngarkoi **Komitetin Delors**  të shqyrtonte mundësitë dhe rrugët për krijimin e **Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (BEM)** . Një vit më vonë, Raporti Delors do t'u hapte rrugën negociatave për **Traktatin**  e Bashkimit Evropian, i cili krijoi Bashkimin Evropian (BE) dhe amendoi Traktatin themelues të Komunitetit Evropian. I njohur ndryshe edhe si Traktati i Mاستrihtit, për shkak të qytetit ku u nënshkrua në shkurt të vitit 1992, Traktati i Bashkimit Evropian hyri në fuqi më 1 nëntor 1993.

Rruga drejt BEM-it në Evropë kaloi në tre faza. Faza e parë (1990-1993) u karakterizua nga ngritja e një tregu të përbashkët evropian nëpërmjet heqjes të të gjitha pengesave të brendshme ndaj lëvizjes së lirë të personave, të mallrave, të kapitalit dhe të shërbimeve brenda Evropës.

Faza e dytë (1994-1998) filloi me krijimin e **Institutit Monetar Evropian**  dhe u përqendrua më së shumti në përgatitjet teknike për monedhën e përbashkët evropiane, në shmangien e deficiteve të larta dhe në konvergimin

<sup>1</sup> Pierre Werner ishte Kryeministër i Luksemburgut gjatë asaj kohe.



Marrëveshja e Mاستrihtit u nënshkrua në vitin 1992

Tre faza drejt BEM-it  
1. Tregu i Përbashkët Evropian  
2. Instituti Monetar Evropian  
3. BQE dhe euro.

# RRUGA DREJT BASHKIMIT EKONOMIK DHE MONETAR




e politikave ekonomike dhe monetare të shteteve anëtare (për të siguruar stabilitetin e çmimeve dhe financa publike të shëndosha). Faza e tretë nisi më 1 janar të vitit 1999, me fiksimin e parevokueshëm të kurseve të këmbimit, bartjen e kompetencave të politikës monetare tek Banka Qendrore Evropiane (BQE) dhe përdorimin e euros si monedhë e vetme. Më 1 janar 2002, kartëmonedhat dhe monedhat euro u hodhën në qarkullim në vendet pjesëmarrëse dhe në fund të shkurtit 2002 kartëmonedhat dhe monedhat kombëtare nuk gëzuan më kurs ligjor.

Politika ekonomike të qëndrueshme dhe pavarësia e bankave qendrore.

## 1.3 KRITERET E KONVERGJENCËS

Vendet që dëshirojnë të adoptojnë euron si monedhën e tyre duhet të arrijnë një shkallë të lartë "konvergjence të qëndrueshme". Shkalla e konvergjencës vlerësohet në bazë të disa kritereve të shprehura në Traktatin e Mاستrihtit, i cili përcakton se një vend duhet të ketë:

- nivel të lartë të **stabilitetit të çmimeve** 
- financa publike të shëndosha;
- kurs këmbimi të qëndrueshëm;
- norma interesi afatgjata të ulëta dhe të qëndrueshme.

17 shtete anëtare kanë adoptuar monedhën euro.

Në maj të vitit 1998, në Samitin e Bashkimit Evropian në Bruksel u vendos se vetëm 11 shtete anëtare nga 15 që numëronte asokohe BE-ja - përkatësisht: Austria, Belgjika, Finlanda, Franca, Gjermania, Holanda, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Portugalia dhe Spanja – kishin përmbushur kriteret për të kaluar në euro, e cila në 1 janar 1999 do të bëhej zyrtarisht monedha e përbashkët e këtyre vendeve. Greqia iu bashkua këtij grupi më 1 janar 2001. Pas përmbushjes së kritereve, në Eurozonë hynë edhe vende të tjera - Sllovenia në 1 janar 2007, Qiproja e Malta në 1 janar 2008, Sllovakia në 1 janar 2009 dhe Estonia në 1 janar 2011. Suedia nuk i ka plotësuar ende të gjitha kriteret, ndërsa Danimarka dhe Mbretëria e Bashkuar kanë negociuar për "një status të veçantë", të cilin e gëzojnë edhe sot. Në protokollet e bashkëlidhura Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian, këtyre dy vendeve iu dha e drejta e zgjedhjes

 Referojuni fjalorthit



për të marrë pjesë ose jo në fazën e tretë të BEM-it, pra, për të adoptuar ose jo euron. Deri tani, të dyja shtetet janë mbështetur në “klauzolën e mospjesëmarrjes” dhe kanë informuar **Këshillin e BE-së** se aktualisht nuk dëshirojnë të kalojnë në fazën e tretë, që do të thotë se ende nuk kanë vendosur të bëhen pjesë e zonës euro.

Suedia së bashku me shtatë vende anëtare nga dymbëdhjetë që iu bashkuan BE-së që nga viti 2004, konsiderohen si vende anëtare “me derogim”, pasi nuk i kanë përmbushur ende të gjitha kërkesat për adoptimin e euros. **Derogimi** nënkupton përjashtimin nga disa prej dispozitave që zbatohen zakonisht qysh në fillim të fazës së tretë të BEM-së. Këtu përfshihen të gjitha dispozitat lidhur me kalimin e kompetencave të vendimmarrjes së politikës monetare të **Këshilli Drejtues** i BQE- së.

Ashtu si Suedia, edhe shtetet e tjera anëtare të BE-së, të cilat nuk e kanë adoptuar akoma euron, nuk e gëzojnë të drejtën e “klauzolës së mospjesëmarrjes”, të zbatuar për Mbretërinë e Bashkuar dhe Danimarkën.

Me fjalë të tjera, për shtetet e reja anëtare hyrja në Bashkimin Evropian nënkupton angazhimin e tyre për të adoptuar euron si qëllim përfundimtar, sigurisht pas plotësimit të **kritereve të konvergencës**. BQE dhe **Komisioni Evropian** përgatisin raporte periodike dyvjeçare ose raporte me kërkesë të një shteti anëtar me derogim - mbi përparimin e bërë drejt përmbushjes së kritereve të konvergencës. Raportet e konvergencës, ndër të tjera, marrin parasysh edhe faktorë që ndikojnë në integrimin e vendit në zonën euro. Këto raporte shërbejnë si bazë për vendimin e Këshillit Evropian për të lejuar ose jo një vend anëtar të marrë pjesë edhe në Eurozonë.

Dy anëtarë zgjedhën të “mos përfshihen”

Shtete të reja anëtare janë të angazhuara në procesin e adoptimit të euros si qëllim përfundimtar

#### **4 KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË EUROZONËS**

Përpara se të hynin në Eurozonë, vendet anëtare përfaqësonin ekonomi relativisht të hapura. Megjithatë, sot ato janë pjesë e një ekonomie më të madhe dhe shumë më tepër autonome. Përmasat e Eurozonës e bëjnë këtë ekonomi të krahasueshme me ato më të rëndësishmet në botë, si ekonomia e Shteteve të Bashkuara apo e Japonisë.



# RRUGA DREJT BASHKIMIT EKONOMIK DHE MONETAR



Një nga ekonomitë më të mëdha në botë

Me një popullsi prej 329 milionë në 2009, Eurozona është një nga ekonomitë më të mëdha në botë. Në të njëjtën periudhë, Bashkimi Evropian numëron 27 shtete anëtare dhe një popullsi prej 501 milionë banorë, krahasuar me Shtetet e Bashkuara dhe Japoninë që kanë përkatësisht 299 dhe 128 milionë banorë.

Për sa i përket **prodhimin të brendshëm bruto (PBB)** të shprehur sipas **paritetit të fuqisë blerëse**, në vitin 2009 Shtetet e Bashkuara të Amerikës përfaqësonin ekonominë më të madhe në botë me 20.5% të PBB-së botërore, të ndjekura nga Eurozona me 15.2% dhe Japonia me 6.0%. Nëse vendet e zonës euro do të llogariteshin më vete, pjesa e secilit do të ishte shumë e vogël, ku ekonomia më e madhe përbënte vetëm 3.9% të PBB-së botërore në 2009.

Varësi e kufizuar ndaj tregtisë së jashtme

Ndonëse ekonomia e Eurozonës mund të ndikohet ndjeshëm nga zhvillimet në ekonominë botërore, fakti që ajo është një ekonomi më pak e hapur do të thotë se luhajtjet në çmimet e mallrave të importuara kanë vetëm një ndikim të kufizuar në çmimet e brendshme. Megjithatë, ajo është më e hapur se sa ekonomia e Shteteve të Bashkuara ose e Japonisë. Në 2009 eksportet e mallrave dhe të shërbimeve të zonës euro, si përqindje ndaj PBB-së, qenë shumë më të larta (19.6%), në krahasim me ato të Shteteve të Bashkuara (10.9%) dhe Japonisë (13.3%).

Një treg tërësisht i përbashkët për mallrat dhe shërbimet

## 1.5 PËRPARËSITË E EUROS

Me **Bashkimin Ekonomik dhe Monetar (BEM)**, Bashkimi Evropian shënoi një tjetër hap të rëndësishëm drejt krijimit të tregut të brendshëm. Tashmë bizneset dhe konsumatorët e kanë më të lehtë të krahasojnë çmimet dhe të gjejnë furnizuesit më të leverdisshëm për ta në Eurozonë. Veç kësaj, BEM-i ka sjellë stabilitet ekonomik dhe monetar në të gjithë Evropën, gjë që ndihmon në rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. Po kështu, monedha e përbashkët i dha fund çrregullimeve që shkaktoheshin nga luhajtjet e papritura të kursit të këmbimit të monedhave të mëparshme kombëtare.

Përdorimi i monedhave dhe kartëmonedhave euro që nga 1 janari 2002, e ka bërë më të thjeshtë udhëtimin nëpër Eurozonë, pasi çmimet e mallrave




Referojuni fjalorthit



dhe të shërbimeve janë lehtësisht të krahasueshme, kurse pagesat kryhen në të njëjtën monedhë në të gjitha vendet e saj.

Me kalimin në euro, brenda Eurozonës u eliminuan kostot e transaksioneve valutore dhe rreziqet lidhur me kursin e këmbimit. Në të shkuarën, faktorë të tillë pengonin konkurrencën midis vendeve, ndërkohë që rritja e saj nxiti një përdorim më efikas të burimeve ekonomike. Monedha e përbashkët thjeshtëzoi ndjeshëm vendimet mbi investimet, për arsye se luhatjet e kursit të këmbimit nuk ndikojnë më në të ardhurat nga investimet e realizuara në vende të ndryshme të Eurozonës.

Përpara hyrjes së euros, si rregull, tregjet financiare ishin përgjithësisht të kufizuara brenda hapësirave kombëtare, dhe instrumentet financiare (si obligacionet dhe aksionet) shpreheshin në monedhat vendase. Adoptimi i monedhës së përbashkët përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të integritetit të tregjeve financiare të Eurozonës dhe do të vazhdojë të ndikojë në strukturën e ekonomisë së kësaj zone. Nivelet e ndryshme të integritetit mund të vërehen në të gjithë segmentet e sistemit financiar:

- **Tregu monetar ndërbankar**  i Eurozonës është tërësisht i integruar.
- **Tregu i obligacioneve**  të shprehura në euro, ka një nivel të mirë integriteti, intensiteti dhe likuiditeti, si dhe paraqet mundësi të shumta zgjedhjesh për sa i përket investimeve dhe financimeve.
- **Tregu i aksioneve**  të Eurozonës shihet gjithmonë e më shumë si një treg i përbashkët.
- Aktiviteti i shkrirjes dhe përthithjes në sektorin bankar është rritur në Eurozonë si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkufitar.

Intensiteti dhe cilësia e një tregu financiar të integruar ndikojnë pozitivisht në financimin e rritjes ekonomike, e për rrjedhojë në krijimin e vendeve të reja të punës. Individët kanë një mundësi më të madhe zgjedhjeje të planeve të tyre të kursimeve dhe të investimeve. Biznesi mund të drejtohet në një treg kapitali shumë më të madh për financimin e aktivitetit të tij dhe mund të përdorë instrumente të reja për t'u mbrojtur nga rreziqet financiare si dhe për të përmirësuar menaxhimin e investimeve të tij.

Rreziqet nga kursi i këmbimit dhe kostot e transaksioneve u eliminuan

Integriteti i tregjeve financiare

# MOMENTET HISTORIKE



**1952**



Belgjika, Franca, Gjermania, Holanda, Italia dhe Luksemburgu dhe themelojnë Komunitetin Evropian të Qymyrit dhe të Çelikut (KEQÇ).

**1958**

Hyn në fuqi Traktati i Romës; themelohen Komuniteti Ekonomik Evropian (KEE) dhe Komuniteti Evropian për Energjinë Atomike (EURATOM).

**1967**

Tre komunitetet (KEQÇ, KEE, EURATOM) bashkohen nga Traktati i Shkrirjes.

**1970**



Prezantohet Raporti Werner, projekti i parë i bashkimit monetar.

**1973**

Danimarka, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar anëtarësohen në Komunitetet Evropiane (KE).

**1979**

Themelohet Sistemi Monetar Evropian (SME).

**1981**



Greqia anëtarësohet në Komunitetet Evropiane.

**1986**

Portugalia dhe Spanja anëtarësohen në Komunitetet Evropiane.

**1987**



Hyn në fuqi Akti Unik Evropian, duke hapur rrugën tregut të përbashkët.

**1989**



Komisioni Delors prezanton raportin mbi Bashkimin Ekonomik dhe Monetar (BEM).

## 1990

Fillon faza e parë e BEM-it.

## 1993

Hyn në fuqi Traktati i Bashkimit Evropian (Traktati i Mاستrihtit).

## 1994



Themelohet Instituti Monetar Evropian (IME) në Frankfurt.

## 1995

Austria, Finlanda dhe Suedia anëtarësohen në BE.

## 1998

Shkrihet Instituti Monetar Evropian dhe themelohet Banka Qendrore Evropiane (BQE) në Frankfurt.

## 1999



Fillon faza e tretë e BEM-it për njëmbëdhjetë shtetet pjesëmarrëse. Futet në përdorim euro si monedhë e përbashkët.

Hyn në fuqi Traktati i Bashkimit Evropian i ndryshuar (Traktati i Amsterdimit).

## 2001

Greqia hyn në zonën euro si shteti i dymbëdhjetë.

## 2002

Hynë në qarkullim kartëmonedhat dhe monedhat Euro.

## 2003

Hyn në fuqi Traktati i Bashkimit Evropian i ndryshuar (Traktati i Nicës).

## 2004



Në 1 maj, dhjetë shtete të tjera hynë në BE.

## 2007

Numri i vendeve anëtare të BE-së shkon në 27 me hyrjen e Bullgarisë dhe të Rumanisë. Sllovenia pranohet në Eurozonë. Në dhjetor firmoset Traktati i Lisbonës.

## 2008

Malta dhe Qipro bëhen pjesë e zonës euro, e cila në këtë moment numëron 15 shtete anëtare.


## 2009

Sllovakia pranohet në zonën euro.

## 2011

Estonia pranohet në zonën euro.

# STRUKTURA DHE DETYRAT



## 2.1 SISTEMI EVROPIAN I BANKAVE QENDRORE DHE EUROSISTEMI

**Sistemi Evropian i Bankave Qendrore (SEBQ)** u themelua në përputhje me Traktatin e Mastrohitit, me Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe atë të **Bankës Qendrore Evropiane**. Ai përbëhet prej Bankës Qendrore Evropiane (BQE) dhe bankave qendrore kombëtare (BQK) të të gjitha shteteve anëtare të BE-së.

**Eurosistemi** përfshin BQE-në dhe bankat qendrore kombëtare të shteteve anëtare të BE-së, që kanë adoptuar euron (sot 17 vende).

Organet vendimmarrëse të BQE-së janë **Këshilli Drejtues** dhe **Bordi Ekzekutiv**. Këshilli Drejtues merr vendimet që i përkasin politikës monetare të BQE-së, ndërsa Bordi Ekzekutiv zbaton këto vendime dhe është përgjegjës për administrimin e përditshëm të saj. Organi i tretë vendimmarrës i BQE-së është **Këshilli i Përgjithshëm**, i cili do të vazhdojë të ekzistojë për aq kohë sa do të ketë shtete anëtare të BE-së që nuk e kanë adoptuar ende euron.

BQE është një organizatë me karakter mbikombëtar

## 2.2 BANKA QENDRORE EVROPIANE

BQE-ja është institucion me karakter mbikombëtar. Ajo u themelua në qershor të vitit 1998 në Frankfurt, duke marrë në dorëzim funksionet e paraardhësit të saj, Institutit Monetar Evropian (IME). BQE është personalitet juridik. Aktualisht, zyrat e saj ndodhen në tre godina në zemër të Frankfurtit, por jo për shumë kohë, pasi në 2014, ajo do të zhvendoset në pjesën lindore të qytetit, në mjediset e reja të cilat janë në ndërtim e sipër.

Punonjësit e BQE-së vinë nga njëzeteshtatë shtetet anëtare të BE-së dhe kjo e bën këtë institucion të ketë një karakter me të vërtetë evropian.



Rruga drejt Bashkimit  
Ekonomik dhe Monetar



Struktura dhe detyrat

2.1 Sistemi Evropian i Bankave Qendrore dhe Eurosistemi	2.5 Bankat qendrore kombëtare
2.2 Banka Qendrore Evropiane	2.6 Organet vendimmarrëse të BQE-së
2.3 Detyrat e Eurosistemit	2.7 Komitetet e SEBQ-së
2.4 Pavarësia	



Politika monetare




Sistemi TARGET 2



Kartëmonedhat dhe monedhat Euro



Mbikëqyrja bankare



## 2.3 DETYRAT E EUROSISTEMIT

Eurosistemi ka katër detyra kryesore. Së pari, zbaton politikën monetare të miratuar nga Këshilli Drejtues i BQE-së, që do të thotë vendimet mbi normat bazë të interesit të BQE-së (**norma e interesit minimal** mbi **operacionet kryesore të rifinancimit**, **normat e interesit për kredinë njëditore** dhe të depozitave njëditore) si edhe aty ku është e përshtatshme, vendime që kanë të bëjnë me objektivat monetare dhe ofertën e rezervave). Përgjegjësia për zbatimin e politikës monetare i përket Bordit Ekzekutiv, i cili për të kryer këtë detyrë u jep udhëzime bankave qendrore kombëtare. Për shembull, Bordi Ekzekutiv përcakton një herë në javë shpërndarjen e likuiditetit për sektorin bankar nëpërmjet operacioneve kryesore të rifinancimit.

Këshilli Drejtues vendos normat bazë të interesit

Detyra e dytë dhe e tretë e Eurosistemit është kryerja e **operacioneve të këmbimit valutor** dhe mbajtja e administrimi i rezervave valutore të shteteve të Eurozonës.

Rezerva valutore mbahet nga BQE-ja dhe bankat qendrore kombëtare

Bankat qendrore kombëtare të Eurosistemit kanë transferuar rezerva valutore në BQE, që kapin një total prej 40 miliardë eurosh, nga të cilat 85% janë në zotërimet dhe 15% në ar. Për këto rezerva të vendosura pranë BQE-së, që ndryshe quhen edhe **pretendime të remunerueshme**, bankat qendrore kombëtare përfitojnë interesa në euro. Bankat qendrore të Eurosistemit janë të përfshira në administrimin e rezervës valutore të BQE-së: ato veprojnë si agjentë të saj duke zbatuar udhëzimet për menaxhimin e portofolit, që ajo përcakton. Pjesa e mbetur e rezervës valutore të Eurosistemit i përket bankave qendrore kombëtare dhe administrohet prej tyre. Operacionet mbi këto lloj rezervash rregullohen nga Eurosistemi, veçanërisht ato të cilat e tejkalojnë një nivel të caktuar dhe që kërkojnë miratimin e BQE-së.

Detyra e katërt kryesore e Eurosistemit është nxitja e funksionimit normal të sistemit të pagesave. Gjithashtu, Eurosistemi kontribuon në mbikëqyrjen financiare të sistemit dhe ofron këshillim për ligjvënësit lidhur me fushat e tij të kompetencës dhe përpilon statistika financiare dhe monetare.

Traktati i Mastrohitit parashikon gjithashtu se BQE-ja gëzon të drejtën ekskluzive për emetimin e kartëmonedhave euro.

# STRUKTURA DHE DETYRA



## PAVARËSIA

**2.4** Gjatë kryerjes së detyrave të lidhura me Eurosistemin, BQE-ja dhe bankat qendrore kombëtare, nuk mund të kërkojnë apo të pranojnë udhëzime nga institucionet apo organet komunitare, as nga qeveritë e shteteve anëtare të BE-së apo nga ndonjë organizëm tjetër. Po ashtu, nga ana tjetër, as të lartpërmendurit nuk mund të kërkojnë të influencojnë në asnjë lloj mënyre anëtarët e organeve vendimmarrëse të BQE-së dhe të bankave qendrore kombëtare në përmbushjen e detyrave të tyre.

### Pavarësia personale

Me qëllim që të sigurohet mbarëvajtja e mandateve të guvernatorëve të bankave qendrore kombëtare dhe të anëtarëve të **Bordit Ekzekutiv**<sup>[1]</sup>, statuti i SEQB-së dhe BQE-së parashikon:

- një mandat prej jo më pak se pesë vjetësh për guvernatorët e bankave qendrore kombëtare;
- një mandat të parinovueshëm prej jo më pak se tetë vjetësh për anëtarët e Bordit Ekzekutiv të BQE-së;
- largimin e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv nga detyra vetëm në rastet ekstreme të paaftësisë ose të shkeljeve të rënda; organi përgjegjës për zgjidhjen e këtyre çështjeve është **Gjykata e Drejtësisë së Komuniteteve Evropiane**<sup>[2]</sup>.

### Pavarësia operationale

Eurosistemi gëzon edhe pavarësi operationale. BQE-ja dhe BQK-të zotërojnë instrumentet dhe kompetencat e nevojshme për të realizuar një politikë monetare të efektshme dhe mund të vendosin në mënyrë të pavarur kur dhe si t'i përdorin ato.

Eurosistemit i ndalohet t'u japë hua organeve komunitare apo enteve kombëtare të sektorit publik. Në këtë mënyrë, sigurohet pavarësia prej çdo lloj influence nga autoritetet publike. Për më tepër, **Këshilli Drejtues**<sup>[3]</sup> i BQE-së ka të drejtën të miratojë rregullore detyruese në përmbushje të detyrave të SEBQ-së dhe, në raste të tjera, siç përcaktohet në aktet specifike të **Këshillit të BE-së**<sup>[4]</sup>.

[1] Referojuni fjalorthit



Nationale Bank van België / Banque Nationale de Belgique



Deutsche Bundesbank



Eesti Pank



Central Bank of Ireland



Bank of Greece



Banco de España



Banque de France



Banca d'Italia



Central Bank of Cyprus



Banque centrale du Luxembourg



Bank Ċentrali ta' Malta/Central Bank of Malta



De Nederlandsche Bank



Oesterreichische Nationalbank



Banco de Portugal



Banka Slovenije



Národná banka Slovenska



Suomen Pankki  
Finlands Bank





# STRUKTURA DHE DETYRA



## 2.5 BANKAT QENDRORE KOMBËTARE

Bankat qendrore kombëtare, anëtare të Eurosistemit, janë persona juridikë (sipas ligjit të shtetit përkatës) të dallueshëm nga Banka Qendrore Evropiane. Në të njëjtën kohë, ato janë pjesë e Eurosistemit i cili ka përgjegjësinë e ruajtjes së **stabilitetit të çmimeve** në Eurozonë; ato veprojnë në përputhje me udhëzimet e BQE-së për zbatimin e detyrave të Eurosistemit.

BQK-të kryejnë operacione të politikës monetare

BQK-të janë të angazhuara në zbatimin e politikës monetare të përbashkët të Eurozonës. Ato kryejnë operacione të politikës monetare, si për shembull u ofrojnë likuiditet **institucioneve të kreditit**, sigurojnë shlyerjen e pagesave të brendshme dhe ndërkufitare (pagesa jo *cash*) dhe administrojnë rezervat valutore për llogari të tyre dhe si agentë të BQE-së.

BQK-të kryejnë gjithashtu një detyrë tjetër të rëndësishme, atë të mbledhjes të dhënave statistikore kombëtare, si dhe emetimin dhe administrimin fizik të kartëmonedhave euro, në vendet e tyre. Ato kryejnë po ashtu funksione që nuk përfshihen në Statutin e SEBQ dhe të BQE-së, me përjashtim të rasteve kur Këshilli Drejtues i konsideron të papajtueshme me objektivat dhe funksionet e Eurosistemit.

Legjislacionet kombëtare mund t'u caktojnë BQK-ve detyra të cilat nuk lidhen me politikën monetare. Disa prej BQK-ve, për shembull, janë të angazhuara në mbikëqyrjen e sistemit bankar dhe/ose veprojnë si bankier kryesor për qeverinë.

Këshilli drejtues mbledhet një herë në dy javë, ditën e enjte

## 2.6 ORGANET VENDIMMARRËSE TË BQE-SË

Këshilli Drejtues i Bankës Qendrore Evropiane përbëhet prej anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të saj dhe guvernatorëve të bankave qendrore kombëtare të Eurozonës. Statuti i SEBQ-së përcakton se Këshilli Drejtues duhet të mbledhet të paktën 10 herë në vit. Datat e mbledhjeve vendosen nga vetë Këshilli, në bazë të propozimeve të Bordit Ekzekutiv. Mbledhjet mund të zhvillohen edhe me videokonferencë, përveç rasteve kur të paktën tre

Referojuni fjalorthit



gubernurë nuk janë dakord. Aktualisht, Këshilli Drejtues mbledhet dy herë në muaj, zakonisht të enjten e parë dhe të tretë të muajit. Në përgjithësi, çështjet mbi politikën monetare diskutohen vetëm gjatë mbledhjes së parë.

Presidenti i **Këshillit të BE-së** dhe një anëtar i **Komisionit Evropian** mund të marrin pjesë në këto mbledhje, por vetëm anëtarët e **Këshillit Drejtues** kanë të drejtë vote. Secili anëtar i Këshillit Drejtues ka të drejtën e një vote dhe me përjashtim të vendimeve mbi çështjet financiare të BQE-së, Këshilli Drejtues i merr vendimet me një shumicë të thjeshtë votash. Në rastet e barazimit, Presidenti ka të drejtën e votës vendimtare. Për sa i përket çështjeve financiare, si nënshkrimi i kapitalit të BQE-së, transferimi i rezervave valutore dhe shpërndarja e të ardhurave monetare, votat numërohen sipas peshës së kuotave që BQK-të zotërojnë në kapitalin e nënshkruar të BQE-së.

E drejta e Këshillit Drejtues për marrjen e vendimeve më të rëndësishme të **Eurosistemit**, siç janë ato strategjike, sanksionohet në Traktatin e Bashkimit Evropian dhe në statutet e SEBQ dhe BQE-së.

Përgjegjësitë kryesore të Këshillit Drejtues janë:

- hartimi i politikës monetare të Eurozonës, pra marrja e vendimeve në lidhje me nivelin e normave të interesit;
- miratimi i orientimeve dhe marrja e vendimeve të duhura për kryerjen e detyrave kryesore të Eurosistemit.

Gjatë procesit të marrjes së vendimeve mbi politikën monetare apo lidhur me detyrat e tjera të Eurosistemit, Këshilli Drejtues analizon dhe mban parasysh zhvillimet të Eurozonës në tërësinë e saj.



Fokusi është në Eurozonë

**Bordi Ekzekutiv** përbëhet nga Presidenti, Zëvendëspresidenti i BQE-së dhe nga katër anëtarë të tjerë. Emërimi i tyre bazohet në kriteret e përvojës së dalluar profesionale për çështje të politikës monetare e bankare, në konsensus të përbashkët me përfaqësuesit më të lartë të qeverive e të shteteve të Eurozonës, me rekomandim të **Këshillit të Bashkimit Evropian** e pas

Bordi Ekzekutiv mbledhet çdo të martë

# STRUKTURA DHE DETYRA




konsultimit të këtij të fundit me **Parlamentin Evropian**  dhe Këshillin Drejtues të Bankës Qendrore Evropiane. Bordi Ekzekutiv mbledhet zakonisht çdo të martë. Presidenti i BQE-së ose, në mungesë të tij, Zëvendëspresidenti drejton mbledhjet e Këshillit Drejtues, të Bordit Ekzekutiv dhe të Këshillit të Përgjithshëm të BQE-së. Presidenti ftohet në takimet e **Grupit të Euros** , një grupim informal i ministrave të ekonomisë dhe të financave të Eurozonës. Gjithashtu, ai mund të marrë pjesë në takimet e Këshillit të Bashkimit Evropian, ku trajtohen çështje lidhur me objektivat dhe detyrat e Eurosistemit.

Përgjegjësitë kryesore të Bordit Ekzekutiv janë:

- të përgatisë takimet e Këshillit Drejtues;
- të zbatojë politikën monetare të Eurozonës në përputhje me udhëzimet dhe vendimet e parashtruara nga Këshilli Drejtues, duke i dhënë në këtë mënyrë instruksionet përkatëse bankave qendrore kombëtare;
- të administrojë punën e përditshme të Bankës Qendrore Evropiane;
- të ushtrojë kompetenca të caktuara, përfshi një rol rregullator, të autorizuar nga Këshilli Drejtues.

Këshilli i Përgjithshëm mbledhet katër herë në vit

Këshilli i Përgjithshëm përbëhet nga Presidenti, nga Zëvendëspresidenti i Bankës Qendrore Evropiane dhe nga guvernatorët e bankave qendrore të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Anëtarët e tjerë të Bordit Ekzekutiv, Presidenti i Këshillit të Bashkimit Evropian dhe një anëtar i **Komisionit Evropian**  mund të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm, por nuk kanë të drejte vote. Mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm mund të organizohen kurdoherë që Presidenti e gjykon të nevojshme ose të paktën me kërkesë të tre anëtareve të tij. Këshilli i Përgjithshëm zakonisht mbledhet në Frankfurt çdo tre muaj.

Këshilli i Përgjithshëm nuk ka përgjegjësi për vendimet e politikës monetare në Eurozonë. Ai ka marrë përsipër të përmbushë disa detyra që përpara i takonin Institutit Monetar Evropian, të cilat Banka Qendrore Evropiane duhet t'i përmbushë gjatë fazës së tretë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, për aq kohë sa një pjesë e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian nuk kanë adoptuar ende euron. Kjo nënkupton se detyra kryesore e Këshillit të Përgjithshëm është

 Referojuni fjalorthit



të raportojë rreth përparimit që është bërë drejt përmbushjes së kriterëve të konvergencës nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat ende nuk kanë adoptuar euron, si dhe të japë këshilla rreth përgatitjeve të nevojshme për adoptimin e monedhës euro. Gjithashtu, ai kryen funksionin e këshilltarit në SEBQ dhe ndihmon në mbledhjen e informacionit statistikor.

## 2.7 KOMITETET E SEBQ

Organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore Evropiane mbështeten nga komitetet e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Gjithashtu, këto komitete janë të rëndësishme për bashkëpunimin e brendshëm në SEBQ. Ato përbëhen nga anëtarë të Bankës Qendrore Evropiane dhe të bankave qendrore kombëtare (BQK) të **Eurosistemit**, si dhe nga anëtarë të organeve të tjera kompetente, siç mund të jenë autoritetet mbikëqyrëse kombëtare në rastin e Komitetit të Mbikëqyrjes Bankare. BQK-të e shteteve joanëtare të Eurozonës kanë emëruar ekspertë për të marrë pjesë në takimet e Komiteteve të SEBQ-së, sa herë që këto komitete mblidhen për të trajtuar çështje që janë kompetencë e Këshillit të Përgjithshëm. Mandatet e komiteteve përcaktohen nga **Këshilli Drejtues**, të cilit komitetet i raportojnë nëpërmjet **Bordit Ekzekutiv**. SEBQ numëron këto komitete: Komiteti i Kontabilitetit dhe i të Ardhurave Monetare, Komiteti i Mbikëqyrjes Bankare, Komiteti i Kartëmonedhave, Komiteti i Metodologjisë së Kostos, Komiteti i Komunikimit të Eurosistemit/SEBQ, Komiteti Drejtues i Sistemeve të Informacionit i Eurosistemit, Komiteti i Teknologjisë së Informacionit, Komiteti i Auditorëve të Brendshëm, Komiteti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Komiteti Ligjor, Komiteti i Operacioneve të Tregut të Hapur, Komiteti i Politikës Monetare, Komiteti i Sistemit të Pagesave dhe Shlyerjeve dhe Komiteti i Statistikave.

Gjithashtu, në vitin 1998 Këshilli Drejtues themeloi Komitetin e Buxhetit, i cili përbëhet nga anëtarë të Bankës Qendrore Evropiane dhe të bankave qendrore kombëtare të Eurosistemit. Komiteti i Buxhetit ndihmon Këshillin Drejtues për çështjet e buxhetit të Bankës Qendrore Evropiane.

Së fundi, në vitin 2005 u themelua Konferenca e Burimeve Njerëzore, e cila përbëhet nga anëtarë të SEBQ-së. Kjo konferencë ka për qëllim promovimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe punës në grup midis bankave qendrore të Eurosistemit/SEBQ-së në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Komitetet e ekspertëve mbështesin organet vendimmarrëse

# POLITIKA MONETARE



## 3.1 STABILITETI I ÇMIMEVE

Objektivi kryesor i **Eurosistemit** është ruajtja e **stabilitetit të çmimeve**. Pa cënuar arritjen e objektivit të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, Eurosistemi mbështet edhe politikat të përgjithshme ekonomike të Komunitetit Evropian.

Prioritet kryesor është stabiliteti i çmimeve

Neni 2 i **Traktatit** të Bashkimit Evropian përcakton se Bashkimi Evropian ka për qëllim promovimin “e përparimit ekonomik dhe social, rritjen e nivelit të punësimit si dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar”. Eurosistemi kontribuon në përmbushjen e këtyre objektivave duke ruajtur stabilitetin e çmimeve. Gjithashtu, ai mban parasysh këto objektiva gjatë ndjekjes së objektivit të tij të stabilitetit të çmimeve. Në rast konflikti të këtyre objektivave, BQE-ja duhet t’i japë prioritet ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.

Eurosistemi vepron sipas parimeve të ekonomisë së tregut të hapur dhe të konkurrencës së lirë që mbështet shpërndarjen efikase të burimeve.

## 3.2 STRATEGJIA E POLITIKËS MONETARE TË BQE-SË

Për të arritur stabilitetin e çmimeve, Banka Qendrore Evropiane duhet të ndikojë tregun monetar dhe si rrjedhojë normat afatshkurtra të interesit. BQE-ja ka adoptuar një strategji që siguron një përjasje sistematike dhe të qëndrueshme në marrjen e vendimeve të politikës monetare. Qëndrueshmëria ndihmon në stabilizimin e pritshmërive të **inflacionit** si dhe në rritjen e besueshmërisë të BQE-së.

Elementi kryesor në hartimin e strategjisë së politikës monetare nga **Këshilli Drejtues i BQE-së** është përkufizimi sasior i **stabilitetit të çmimeve**: “rritja vjetore e **indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit (IHÇK)** në Eurozonë të jetë nën 2 %”. Stabiliteti i çmimeve duhet të ruhet edhe në periudhën afatmesme, duke pasqyruar kështu nevojën e një politike monetare sa më largpamëse. Me ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, BQE-ja synon

Referojuni fjalorthit



Rruga drejt Bashkimit  
Ekonomik dhe Evropian



Struktura dhe detyrat



Politika monetare

3.1 Stabiliteti i çmimeve

3.2 Strategjia e politikës monetare të BQE

3.3 Instrumentet e politikës monetare

3.4 Komunikimi

3.5 Statistika monetare dhe financiare



Sistemi TARGET 2



Kartëmonedhat dhe  
monedhat Euro



Mbikëqyrja bankare



të ruajë normën e inflacionit në nivele të ulëta, por afër 2% gjatë një periudhe afatmesme. Në këtë mënyrë, ajo pasqyron angazhimin për të siguruar një marzh të mjaftueshëm sigurie kundrejt rrezikut të **deflacionit**.

Politika monetare duhet të jetë largpamëse, në mënyrë që të zbusë efektet e vonesave kohore në veprimin e **mekanizmit të transmetimit** (shih pjesën në vijim). Për më tepër, ajo duhet të ankorojë pritshmëritë e inflacionit dhe të ndihmojë në qëndrueshmërinë e zhvillimeve ekonomike.

Politika monetare largpamëse

Krahas përkufizimit të stabilitetit të çmimeve, strategjia e politikës monetare përfshin një vlerësim të hollësishëm të rreziqeve mbi stabilitetin e çmimeve, duke u mbështetur në një analizë ekonomike dhe në një analizë monetare. Çdo vendim i politikës monetare paraprihet nga një vlerësim i kryqëzuar i këtyre dy analizave.

### 3.3 INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

Mekanizmi i transmetimit të politikës monetare fillon me administrimin e likuiditetit të bankës qendrore dhe me orientimin e normave afatshkurtra të interesit.

Tregu i parasë, si pjesë përbërëse e tregut financiar, luan një rol vendimtar në transmetimin e vendimeve të politikës monetare, duke qenë se është tregu i parë, i cili ndikohet nga ndryshimet e politikës monetare. Një treg i parasë i mirëzhvilluar dhe i integruar është thelbësor për një politikë efektive monetare, pasi ai siguron shpërndarje të barabartë të likuiditetit dhe nivel homogjen të normave afatshkurtra të interesit në zonën e monedhës së përbashkët. Ky parakusht u plotësua pothuajse menjëherë pas fillimit të fazës së tretë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, kur tregjet kombëtare të parasë u integruan suksesshëm në një treg efikas të parasë në Eurozonë.

Tregu i parasë është i pari që ndikohet

Për të kontrolluar normat afatshkurtra të interesit, Eurosistemi ka në dispozicion një sërë instrumentesh të politikës monetare si operacionet e tregut të hapur, lehtësirat e përhershme dhe rezervën e detyruar.

# POLITIKA MONETARE



Operacionet e tregut të hapur mund të ndahen në katër kategori:

- **Operacione kryesore të rifinancimit** <sup>☰</sup> - janë transaksione të zakonshme që sigurojnë likuiditet me një frekuencë dhe maturim njëjavor;
- Operacione rifinancimi afatgjatë - janë transaksione që sigurojnë likuiditet, por që kryhen në frekuenca mujore dhe kanë maturitet tremujor;
- Operacione rregulluese - kryhen në raste të veçanta me qëllim rregullimin e normave të interesit dhe administrimin e likuiditetit në treg. Në mënyrë të veçantë, këto operacione kanë për qëllim zbutjen e efekteve të normave të interesit në rast luhatjesh të paparashikuara të likuiditetit; dhe
- Operacione strukturore - mund të kryhen nga Eurosistemi nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta, transaksioneve të shitblerjeve me të drejta të plota dhe emetimit të instrumenteve të borxhit.

## Lehtësirat e Përhershme

Eurosistemi ofron gjithashtu dy lehtësira të përhershme në dispozicion të institucioneve të kreditit për investimin e likuiditetit të tepërt ose huamarrjen e likuiditetit me afat kohor njëditor. Normat e interesit të këtyre dy instrumenteve përcaktojnë korridorin ku mund të luhaten normat e interesit njëditor në tregun ndërbankar.

- kredia njëditore u jep mundësinë **institucioneve të kreditit** <sup>☰</sup> të përftojnë likuiditete njëditore nga bankat qendrore kombëtare kundrejt një lloji kolaterali të parapërcaktuar; dhe
- **depozita njëditore** <sup>☰</sup> u jep mundësinë institucioneve të kreditit të investojnë në depozita njëditore në bankat qendrore kombëtare të Eurosistemit.

## Rezerva minimale e detyruar

Eurosistemi i kërkon gjithashtu, çdo institucion i kreditit të mbajë një rezervë minimale në llogaritë e bankave qendrore kombëtare. Çdo institucion krediti duhet të depozitojë një përqindje të caktuar të sasisë së depozitave të klientëve të vetë (si edhe disa lloje të tjera detyrimesh), në një llogari të bankës së vet qendrore kombëtare, për një periudhë mesatare mbajtjeje prej 1 muaji. Eurosistemi paguan norma interesi afatshkurtër për këto llogari. Sistemi i rezervës së detyruar ka si qëllim stabilizimin e normave të interesit në tregun e parasë dhe të krijojë (ose të zgjerojë) një deficit të strukturuar likuiditeti në sistemin bankar.

<sup>☰</sup> Referojuni fjalorthit



### 3.4 KOMUNIKIMI

Një komunikim i jashtëm efikas luan rol mjaft të rëndësishëm në veprimtarinë e përditshme të bankës qendrore. Komunikimi kontribuon në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë së politikës monetare. Në mënyrë që publiku të kuptojë më mirë politikën monetare dhe aktivitetet e tjera të një banke qendrore, BQE-ja duhet të jetë sa më e hapur dhe transparente. Kjo përbën edhe parimin bazë të komunikimit të jashtëm të Eurosistemit, i cili përfshin një bashkëpunim të ngushtë midis Bankës Qendrore Evropiane dhe bankave qendrore kombëtare.

Për të realizuar një komunikim sa më efikas, BQE-ja dhe BQK-të përdorin një sërë mjeteve komunikimi, ku ndër më të rëndësishmit janë:

- Konferenca e rregullt mujore për shtyp pas mbledhjes së parë të Këshillit Drejtues;
- Publikimi i një Buletini Mujor i cili përmban një përshkrim të hollësishëm të zhvillimeve ekonomike në Eurozonë dhe artikuj mbi aktivitetet e BQE-së;
- Seanca dëgjimore e Presidentit të BQE-së dhe e anëtarëve të tjerë të **Bordit Ekzekutiv** të BQE-së në **Parlamentin Evropian**;
- Intervista dhe fjalime të anëtarëve të organeve vendimmarrëse të BQE-së;
- Njoftime për shtyp të cilat shpjegojnë vendimet dhe pikëpamjet e Këshillit Drejtues;
- Faqet e internetit të BQE-së dhe BQK-ve ku publikohen materiale të ndryshme, duke përfshirë një gamë të pasur statistikore;
- Materiale diskutimi;
- Materiale të veçanta studimore.



# POLITIKA MONETARE



## **3.5** STATISTIKAT MONETARE DHE FINANCIARE

Banka Qendrore Evropiane përpilon dhe publikon statistika monetare dhe financiare në bashkëpunim të ngushtë me bankat qendrore kombëtare. Ky informacion statistikor mbështet vendimmarrjen dhe zbatimin e politikës monetare në Eurozonë.

BQE-ja përpilon agregatët për Eurozonën

Bankat qendrore kombëtare (e në disa raste, autoritete të tjera kombëtare) mbledhin të dhëna nga institucionet financiare ose burime të tjera dhe përlogarisin vlerat totale të agregatëve në nivel kombëtar, të cilat i raportohen Bankës Qendrore Evropiane. Më pas, BQE-ja përpilon vlerat totale të agregatëve në Eurozonë.

Baza ligjore për hartimin, grumbullimin, përpilimin dhe shpërndarjen e statistikave të BQE-së përcaktohet në Statutet e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane, që janë pjesë e anekseve të Traktatit. BQE-ja sigurohet që kriteret e vendosura prej saj në lidhje me statistikat të respektohen nga institucionet financiare dhe subjektet e tjera raportuese, por gjithashtu ajo përpiqet të minimizojë ngarkesën e punës që këto institucione e subjekte mbartin për shkak të raportimit statistikor.




Përgjegjësia për statistikën në nivel evropian ndahet midis Bankës Qendrore Evropiane dhe **Komisionit Evropian** (nëpërmjet Eurostatit, Zyrës së Statistikave të Komuniteteve Evropiane). BQE-ja ka përgjegjësi kryesore ose të përbashkët në lidhje me statistikën monetare, të institucioneve financiare dhe të tregjeve financiare të Eurozonës, statistikën e sektorit të jashtëm (përfshirë Bilancin e pagesave), llogaritë financiare dhe hartimin e llogarive tremujore jofinanciare për aktorët ekonomikë (individët, korporatat dhe qeveria) të Eurozonës. Përgjegjësia për infrastrukturën statistikore (duke përfshirë rishikime sezonale, hartimin e një kuadri statistikor cilësor dhe të standardeve të transmetimit të të dhënave) në nivel evropian ndahet gjithashtu midis këtyre dy institucioneve. Aty ku është e mundur, statistikën e SEBQ-së janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

# SISTEMI TARGET 2



Shlyerja në kohë reale e pagesave në euro

**4. SISTEMI TARGET 2**  
**Sistemi TARGET 2 (Trans-European Automated Real-time Gross settlement Express Transfer)**  zëvendësoi gjeneratën e parë të sistemit TARGET, i cili filloi të funksiononte në janar të vitit 1999, në të njëjtin vit kur u lançua monedha euro.

Ashtu si paraardhësi i tij, sistemi TARGET 2 mundëson shlyerjen e operacioneve të bankave qendrore, të transfertave ndërbankare me vlerë të madhe në monedhën euro si dhe të pagesave të tjera në këtë monedhë. TARGET 2 siguron procesimin në kohë reale, shlyerje në bankën qendrore dhe përfundimtare (te klienti). Megjithatë, ndryshe nga sistemi TARGET, ku procesimi i pagesave ishte i decentralizuar nga bankat qendrore kombëtare, sistemi i ri përdor një platformë të vetme të përbashkët që funksionon e pavarur nga këto banka. Kjo platformë ofron një shërbim më të mirë dhe të harmonizuar, nëpërmjet ekonomive të shkallës, dhe mundëson komisione më të ulëta dhe kosto më të leverdishme. Sistemi i pagesave TARGET 2 nuk ka kufi për vlera minimale apo maksimale.



Rruga drejt Bashkimit  
Ekonomik dhe Evropian



Struktura dhe detyra



Politika monetare



Sistemi TARGET 2



Kartëmonedhat dhe  
monedhat euro



Mbikëqyrja bankare



Duke përdorur sistemin TARGET 2 për pagesat në vlera të mëdha, në mënyrë të veçantë ato në lidhje me veprimet ndërbankare, pjesëmarrësit e tregut marrin një shërbim më shumë dhe japin një kontribut të rëndësishëm në reduktimin e rrezikut sistemik në Bashkimin Evropian, që do të thotë rreziku i “përhapjes nëpërmjet efektit ngjitës” në zona të tjera për shkak të rritjes së numrit dhe vlerës të veprimeve ndërbankare.

Brenda këtij kuadri, një zhvillim tjetër është lançimi i Zonës së Vetme të Pagesave Euro (Single Euro Payments Area - SEPA), me të cilën të gjitha pagesat *jo-cash* në euro konsiderohen si pagesa të brendshme dhe ndryshimi midis veprimeve kombëtare dhe ndërkufitare do të eliminohet. TARGET 2 dhe SEPA do t'i japin një fytyrë të re tregut të pagesave në Eurozonë, duke e bërë më dinamik dhe me kosto më të ulët.

# KARTËMONEDHAT DHE MONEDHAT EURO



## 5.1 KARTËMONEDHAT

Kartëmonedhat euro hynë në qarkullim më 1 janar 2002. Ato kanë shtatë prerje: 5, 10, 20, 50, 100, 200 dhe 500 euro. Përmasa e secilës prerje është në përpjestim të drejtë me vlerën nominale të saj.

Kartëmonedhat përshkruajnë stilet arkitekturale të shtatë periudhave të kulturës dhe historisë evropiane: periudhën klasike, romake, gotike, rilindase, baroke dhe rokoko, arkitekturën e hekurit dhe xhamit dhe arkitekturën moderne të shekullit XX, duke pasqyruar 3 elementë kryesore të arkitekturës: dritaret, portat dhe urat. Asnjë nga motivet e paraqitura në kartëmonedha nuk janë ndërtesa apo monumente ekzistuese.

Dritaret dhe portat në anën e përparme të çdo kartëmonedhe simbolizojnë shpirtin e çiltërsisë dhe të bashkëpunimit në Evropë. Ana e pasme e çdo kartëmonedhe tregon një urë. Këto ura janë përdorur si metaforë e komunikimit midis kombeve evropiane dhe midis Evropës e pjesës tjetër të botës.

Kartëmonedhat euro përmbajnë një sërë elementesh sigurie për t'i mbrojtur nga falsifikimet dhe për t'u dhënë mundësinë përdoruesve të njohin kartëmonedhat e vërteta. Këto elemente sigurie përfshijnë: filigramën, hologramin, fillin e sigurisë dhe bojën e dukshme të ndryshueshme. Për të ndihmuar njerëzit e verbër ose me shikim të kufizuar janë përfshirë edhe veçori të tjera si germa të gdhendura dhe shifra të mëdha.

Kontrollet e larta të cilësisë bëjnë të mundur që të gjitha kartëmonedhat të jenë identike si në cilësi ashtu edhe në pamje. Kartëmonedhat nuk paraqesin simbole kombëtare.

Në fakt, pritet që së shpejti të dalë një seri e re e kartëmonedhave euro. Ajo do të përfshijë elemente të reja sigurie, por nga pikëpamjet e tjera mund të quhet një vazhdim i serisë aktuale, me të njëjtën prerje nga 5 deri në 500 euro, dhe me të njëjtat motive, duke i bërë menjëherë të dallueshme si kartëmonedha euro.

1 Rruga drejt Bashkimit  
Ekonomik dhe Evropian

2 Struktura dhe detyra

3 Politika monetare

4 Sistemi TARGET 2

5 Kartëmonedhat dhe  
monedhat euro

5.1 Kartëmonedhat  
5.2 Monedhat

6 Mbikëqyrja bankare



## 5.2 MONEDHAT

Një euro ndahet në 100 qindarka. Gjithsej janë tetë monedha euro: 1, 2, 5, 10, 20, 50 qindarka, 1 euro dhe 2 euro. Secila prej monedhave ka një faqe evropiane dhe një faqe kombëtare. Pavarësisht përkatësisë kombëtare, të gjitha monedhat euro mund të përdoren pa dallim në të gjitha vendet anëtare të Eurozonës.

Të tetë monedhat e serisë ndryshojnë nga njëra-tjetra në madhësi, peshë, material, ngjyrë dhe trashësi. Për të ndihmuar sa më shumë përdoruesit e tyre, veçanërisht njerëzit e verbër apo ata me shikim të kufizuar, monedhave euro u janë shtuar edhe disa veçori të tjera për t'i bërë prerjet e ndryshme lehtësisht të dallueshme nga njëra-tjetra. Për shembull, çdo monedhë euro ka një prerje rrethore dalluese. Një sistem i përparuar i kontrollit të cilësisë bën të mundur që të gjitha monedhat euro të jenë të këmbyeshme kudo në Eurozonë dhe të përdorshme në të gjitha makinat automatike të shërbimeve me monedhë.

Gjithashtu, një kujdes i veçantë është treguar në prodhimin e monedhave euro me vlerë më të madhe (1 dhe 2 euro) me qëllim mbrojtjen e tyre ndaj falsifikimeve. Dizajni i sofistikuar dyngjyrësh për të dyja këto monedha apo stampimi i figurave në pjesën e buzëve të monedhës 2 euro e bën të vështirë falsifikimin e këtyre monedhave.



# MBIKËQYRJA BANKARE



## 6. MBIKËQYRJA BANKARE

Përgjegjësia e drejtpërdrejtë për mbikëqyrjen bankare dhe stabilitetin financiar u mbetet autoriteteve kompetente të secilit vend anëtar të Bashkimit Evropian. Megjithatë, në përputhje me **Traktatin**, Sistemi Evropian i Bankave Qendrore ka për detyrë të kontribuojë në zbatimin normal të politikave të ndjekura nga autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e kujdesshme të **institucioneve të kreditit** dhe stabilitetin e sistemit financiar.

Kjo detyrë përmbushet kryesisht në tre drejtime.

### Monitorimi i stabilitetit financiar

Së pari, SEBQ-ja monitoron dhe jep një vlerësim rreth stabilitetit financiar në nivel Eurozone/Bashkimi Evropian. Ky aktivitet plotëson dhe mbështet veprimtaritë përkatëse në nivel kombëtar të bankave qendrore dhe të autoriteteve mbikëqyrëse me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar në vendet përkatëse.

- 1 Rruga drejt Bashkimit Ekonomik dhe Evropian
- 2 Struktura dhe detyra
- 3 Politika monetare
- 4 Sistemi TARGET 2
- 5 Kartëmonedhat dhe monedhat euro
- 6 Mbikëqyrja bankare



Së dyti, SEBQ jep këshilla për formulimin dhe rishikimin e kërkesave rregullatore dhe mbikëqyrëse të institucioneve financiare. Një pjesë e mirë e këtij këshillimi realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së BQE-së në organet përkatëse rregullatore dhe mbikëqyrëse evropiane dhe ndërkombëtare si Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare, Komiteti Bankar Evropian dhe Komiteti i Mbikëqyrësve Bankarë Evropianë.

Së treti, BQE-ja promovon bashkëpunimin midis bankave qendrore dhe autoriteteve mbikëqyrëse për çështje me interes të përbashkët (për shembull, mbikëqyrja e sistemit të pagesave, menaxhimi i krizës financiare).

Këto aktivitete organizohen me ndihmën e Komitetit të Mbikëqyrjes Bankare (një nga komitetet e SEBQ të përmendura në paragrafin 2.7), i cili mbledh së bashku ekspertë të bankave qendrore dhe të autoriteteve mbikëqyrëse të BE-së.



**Banka Qendrore:** institucion i cili në përputhje me një akt ligjor, është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare të një zone të caktuar.

**Banka Qendrore Evropiane (BQE):** është themeluar më 1 qershor 1998 me seli në Frankfurt, Gjermani. BQE-ja bashkë me bankat qendrore kombëtare të zonës euro, harton dhe zbaton politikën monetare të shteteve pjesëmarrëse të Eurozonës.

**Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (BEM):** proces i cili çon shtetet anëtare të BE-së drejt harmonizimit të politikave ekonomike e monetare dhe krijimit të një monedhe të përbashkët. Traktati i Mاستrihtit parashikon 3 faza për realizimin e BEM-it. Faza e parë (1 korrik 1990 - 31 dhjetor 1993), kur vendet anëtare lejuan lëvizjen e lirë të kapitaleve midis territoreve të tyre, me një koordinim më të ngushtë të politikave ekonomike dhe bashkëpunim midis bankave qendrore. Faza e dytë (1 janar 1994 - 31 dhjetor 1998) nisi me krijimin e Institutit Monetar Evropian, i cili ishte i fokusuar në përgatitjet teknike për krijimin e një monedhe të vetme, shmangien e deficiteve të tepërta dhe rritjen e konvergencës së politikave ekonomike dhe monetare të vendeve anëtare (për të siguruar stabilitet çmimesh dhe financa të shëndosha publike). Faza e tretë (nga 1 janar 1999) shënohet me fiksimin e parevokueshëm të kursit të këmbimit, përcjelljen e kompetencave të politikës monetare të Banka Qendrore Evropiane (BQE) dhe përdorimin e euros si monedhë e përbashkët.

**Bordi Ekzekutiv:** është një nga organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore Evropiane. Ai përbëhet nga Presidenti, Zëvendëspresidenti dhe katër anëtarë të tjerë, të emëruar me konsensusin e përbashkët të krerëve të shteteve ose të qeverive të shteteve që kanë adoptuar monedhën euro.

**Deflacion:** proces i karakterizuar nga një rënie e vazhdueshme e nivelit të përgjithshëm të çmimeve gjatë një periudhe të konsiderueshme kohe.

**Depozitë njëditore:** një lehtësi e përhershme e Eurosistemit, të cilën kundërpalët mund ta përdorin për të vendosur një depozitë njëditore në një bankë qendrore kombëtare kundrejt një norme interesi të paracaktuar.

**Derogim:** Sipas nenit 122 të Traktatit të KE-së, vendet anëtare që kanë një derogim janë ato shtete të cilat janë në rrugë e sipër të përgatitjeve për adoptimin e euros. Ky status u

referohet tetë vendeve anëtare (Suedisë dhe shtatë vendeve anëtare të reja), ku të drejtat dhe detyrimet për përdorimin e euros si monedhë e vetme nuk aplikohen për këto shtete. Ndryshe është rasti i Danimarkës dhe i Mbretërisë së Bashkuar të cilat gëzojnë klauzolën e mospjesëmarrjes që i shkarkon ato nga detyrimi për të marrë pjesë në fazën e tretë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

**ECOFIN:** shih Këshillin e Bashkimit Evropian.

**Eurosistemi:** përbëhet nga Banka Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore kombëtare të shteteve anëtare të Eurozonës. Ai harton dhe zbaton politikën monetare të Eurozonës.

**Grupi i Euros:** grupim joformal i ministrave të ekonomisë dhe të financave të vendeve anëtare të Eurozonës. Në takimet e këtij grupi, ministrat shqyrtojnë çështje që lidhen me përgjegjësitë e tyre të përbashkëta për euron. Komisioni Evropian dhe Banka Qendrore Evropiane janë të ftuar të marrin pjesë në takimet e Grupit të Euros, të cilat i paraprijnë zakonisht një takimi të planifikuar të ECOFIN-it.

**Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Evropiane:** institucioni që siguron respektimin e së drejtës në interpretimin dhe zbatimin e traktateve dhe të akteve juridike të përcaktuara nga ana e institucioneve të Bashkimit Evropian.

**Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK):** njësisia matëse e çmimeve që përdoret nga Këshilli Drejtues për të vlerësuar stabilitetin e çmimeve në Eurozonë. Ai llogaritet dhe publikohet nga Eurostat, Zyra Statistikore e Komuniteteve Evropiane.

**Inflacioni:** një rritje e vazhdueshme e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, e cila çon në rënien e vazhdueshme të fuqisë blerëse të parasë. Zakonisht inflacioni shprehet si ndryshim vjetor në përqindje i indeksit të çmimeve të konsumit, si IHÇK.

**Institucion krediti:** Bankat dhe bankat e kursimit janë llojet më të zakonshme të institucioneve të kreditit. Sipas nenit 1(1) të direktivës 2000/12/EC, një institucion krediti është (i) një sipërmarrje, qëllimi i të cilës është të mbledhë depozita ose fonde të tjera të ripagueshme nga publiku dhe të japë kredi për llogari të vet; ose (ii) një sipërmarrje ose çdo person tjetër juridik, përveç atyre të parashikuar në pikën (i), që emeton mjete pagese në formën e parasë elektronike. "Para elektronike" do të thotë vlerë monetare që përfaqëson një të drejtë mbi emetuesin, e cila (a) ruhet në një

mekanizëm elektronik; (b) emetohet kundrejt kthimit të fondeve me një shumë jo më të vogël në vlerë sesa vlera monetare e emetuar; dhe (c) pranohet si mjet pagese nga sipërmarrës të ndryshëm nga emetuesi.

**Instituti Monetar Evropian:** institucion i BE-së, përgjegjës për përgatitjet e fazës finale të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. Ai u krijua më 1 janar 1994 dhe u zëvendësua nga Banka Qendrore Evropiane më 1 qershor 1998.

**Këshilli Drejtues:** është organi më i lartë vendimmarrës i Bankës Qendrore Evropiane. Ai përbëhet nga gjashtë anëtarë të Bordit Ekzekutiv të Bankës Qendrore Evropiane dhe guvernatorët e bankave qendrore të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat kanë adoptuar monedhën euro.

**Këshilli Evropian:** përbën shtypsin e nevojshme për zhvillimin e Bashkimit Evropian dhe harton orientimet e përgjithshme politike të tij. Ai përbëhet nga kryetarët e shteteve ose të qeverive anëtare të Bashkimit Evropian dhe nga Presidenti i Komisionit Evropian (shiko Këshillin e BE-së).

**Këshilli i Bashkimit Evropian (Këshilli i Ministrave):** është një institucion i Komunitetit Evropian i përbërë nga përfaqësues të qeverive të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, kryesisht nga ministra përgjegjës për çështje përkatëse që trajtohen (për këtë arsye shpeshherë njihet si Këshilli i Ministrave). Këshilli i Bashkimit Evropian që mbledh ministrat e ekonomisë dhe të financës quhet ECOFIN. Gjithashtu, për vendime të rëndësishme, Këshilli i Bashkimit Evropian mund të mbledhë edhe krerët e shteteve ose të qeverive të vendeve anëtare. Ky institucion nuk duhet të ngatërrohet me Këshillin e Evropës, i cili gjithashtu mbledh në një tryezë krerët e shteteve ose të qeverive të vendeve të Evropës dhe siguron shtypsin e nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të Bashkimit Evropian, si dhe harton orientimet e përgjithshme politike.

**Këshilli i Përgjithshëm:** është një nga organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore Evropiane dhe përbëhet nga Presidenti dhe Zëvendëspresidenti i Bankës Qendrore Evropiane si dhe nga guvernatorët e bankave qendrore të të gjitha vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

**Komisioni Evropian:** është një prej pesë institucioneve të BE-së, i cili u krijua në vitin 1967 për tre Komunitetet Evropiane. Komisioni Evropian ndërmerr nisma në fushën e

legjislacionit komunitar dhe paraqet projektpropozimet përpara Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Ai siguron zbatimin e rregullt të vendimeve të BE-së dhe është përgjegjës për ekzekutimin e buxhetit dhe monitorimin e programeve komunitare. Gjithashtu, Komisioni Evropian monitoron përputhshmërinë me traktatet evropiane dhe ligjin komunitar. Në funksionin e tij si "gardiani i traktateve", së bashku me Gjykatën e Drejtësisë, ai siguron edhe zbatimin e duhur të të drejtës evropiane nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Aktualisht, Komisioni përbëhet nga presidenti dhe 26 komisionerë. Departamentet e tij, të quajtura drejtori të përgjithshme, janë përgjegjëse për zbatimin e politikave të përbashkëta dhe administrimin e përgjithshëm në një fushë të caktuar. Komisioni përfaqëson interesat e përgjithshme të BE-së dhe është i pavarur nga vendet anëtare. Ai emërohet për një afat pesëvjeçar, por mund të shkarkohet nga Parlamenti, përpara të cilit përgjigjet.

**Komiteti Delors:** Në qershor të vitit 1988 Këshilli Evropian miratoi krijimin e një komiteti të kryesuar nga Jacques Delors, asokohe President i Komisionit Evropian, për të studiuar dhe propozuar fazat konkrete nëpër të cilat do të kalonte bashkimi ekonomik dhe monetar. Komiteti përbëhej nga guvernatorët e bankave qendrore të Komunitetit të atëhershëm Evropian (KE-së), si dhe nga Alexandre Lamfalussy, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (BIS), Niels Thygesen, profesor i ekonomisë, Danimarkë, dhe Miguel Boyer, Presidenti i atëhershëm i Bankës së Jashtme të Spanjës. Raporti Delors, i hartuar nga ky Komitet, propozoi që bashkimi ekonomik dhe monetar të arrihej në 3 faza.

**Komuniteti Ekonomik Evropian (KEE):** i themeluar në vitin 1957 nga Traktati i Romës, përbënte një hap përpara drejt integritimit evropian, që do të thotë lëvizje e lirë e njerëzve, e mallrave, e kapitalit dhe e shërbimeve midis vendeve anëtare të BE.

**Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe i Çelikut (KEQÇ):** një nga komunitetet evropiane, që u themelua nga Traktati i Parisit në vitin 1951 dhe krijoi një treg të përbashkët për qymyrin dhe çelikun midis gjashtë vendeve themeluese (Belgjikë, Francë, Gjermani, Holandë, Itali dhe Luksemburg).

**Kredia njëditore:** një lehtësi e përhershme e Eurosistemit, të cilën kundërpalët mund ta përdorin për të marrë kredi njëditore nga banka qendrore kombëtare të Eurosistemit, me një normë interesi të paracaktuar kundrejt kolateralëve të pranueshëm.

**Kriteret e konvergencës:** katër kriteret që duhet të plotësojë çdo vend anëtar i BE-së para se të adoptojë monedhën euro; që nënkuptojnë stabilitet çmimesh, financa publike të shëndosha (një deficit dhe borxh publik i kufizuar në raport me PBB-në), një kurs i qëndrueshëm këmbimi dhe norma afatgjata interesi të ulëta dhe të qëndrueshme.

**Kriteret e Kopenhagenit (kriteret e anëtarësimit):** shtetet që duan të anëtarësohen në BE, duhet të plotësojnë disa kriteret: kriterin politik (institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin e minoriteteve), kriterin ekonomik (një ekonomi tregu funksionale) dhe përafrimin e legjislacionit vendas me *acquis communautaire* (tërësia e legjislacionit të BE-së). Këto kriteret u vendosën nga Këshilli Evropian i Kopenhagenit në qershor të vitit 1993 dhe u konfirmuan nga Këshilli Evropian i Madridit në dhjetor të vitit 1995.

**Lehtësirat e përhershme:** janë lehtësira që banka qendrore vë në dispozicion për institucionet e kreditit me iniciativë të vetë institucioneve. Eurosistemi ofron 2 lehtësi të përhershme, kredinë njëditore dhe depozitën njëditore.

**Mekanizmi i Kursit të Këmbimit II (MCK II):** përbën kuadrin e bashkëpunimit lidhur me politikën e kursit të këmbimit, midis vendeve të Eurozonës dhe vendeve anëtare të BE-së që nuk bëjnë pjesë ende në të. Anëtarësimi në këtë mekanizëm është vullnetar. Megjithatë, vendet anëtare me derogim pritet të anëtarësohen në këtë mekanizëm, duke përcaktuar kështu një kurs qendror të monedhës së tyre kundrejt euros, me një bandë tolerance luhatëse  $\pm 15\%$  rreth kësaj vlere qendrore. Në rastin e vendeve me një shkallë më të lartë konvergjence me zonën euro, me kërkesën e vendit joanëtar të zonës euro mund të bihet dakord për përcaktimin e një bande me nivel tolerance më të ulët.

**MCK II:** Shiko Mekanizmin e Kursit të Këmbimit.

**Mekanizmi i transmetimit:** nënkupton procesin nëpërmjet të cilit, ndryshimet e normës bazë të interesit ndikojnë sjelljen e aktorëve ekonomikë, aktivitetin ekonomik dhe së fundmi, nivelin e përgjithshëm të çmimeve.

**Norma minimale e ofruar:** është norma minimale e ofruar për operacionet kryesore të rifinancimit, e cila përcaktohet nga Këshilli

Drejtues, zakonisht në mbledhjen e parë të çdo muaji.

**Operacionet e këmbimit valutor:** Blerja dhe shitja e valutës. E përkthyer kjo për Eurosistemin, nënkupton blerjen dhe shitjen e monedhave të tjera kundrejt euros.

**Operacionet kryesore të rifinancimit:** operacione të rregullta të tregut të hapur, të cilat kryhen nga Eurosistemi për t'i siguruar sistemit bankar likuiditetin e nevojshëm. Këto operacione mund të kenë formën e ankandeve javore ku bankat bëjnë ofertat e tyre për likuiditet.

**Paraja bazë:** Quhet ndryshe edhe "para me fuqi të lartë" ose "baza monetare". Përfshin gjendjen e kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim plus depozitat që institucionet e kreditit mbajnë në llogarinë e bankës qendrore.

**Pariteti i fuqisë blerëse (PFB):** është norma e konvertimit të monedhës që barazon fuqinë blerëse të monedhave të ndryshme duke eliminuar diferencën e nivelit të çmimeve midis shteteve. E shprehur më thjeshtë, pariteti i fuqisë blerëse tregon raportin e çmimeve në monedha kombëtare për të njëjtat mallra dhe shërbime në shtete të ndryshme.

**Parlamenti Evropian:** institucion evropian i përbërë nga 736 përfaqësues të zgjedhur me votim të përgjithshëm të drejtpërdrejtë nga qytetarët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Ai ndan pushtetin legjislativ me Këshillin e Bashkimit Evropian, që do të thotë se ka të drejtën të miratojë ligje evropiane (direktiva, rregullore, etj.). Ai mund të pranohet, të ndryshohet ose të refuzohet përmbyajtjen e legjislacionit evropian.

**Pretendim i remunerueshëm:** një aset financiar i cili i jep të drejtën mbajtësit të tij të përfitojë interesa nga debitori që e ka lëshuar.

**Prodhimi i brendshëm bruto (PBB):** njësi matëse e aktivitetit ekonomik. PBB-ja i referohet vlerës së të gjitha mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara nga ekonomia e një vendi brenda një afati të caktuar kohor.

**Sistemi Evropian i Bankave Qendrore (SEBQ):** përbëhet nga Banka Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore kombëtare të të gjitha vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

**Sistemi Monetar Evropian:** përpara se euro

të hynte në qarkullim, një pjesë e monedhave të vendeve anëtare të BE-së u lidhën me njëra-tjetrën nëpërmjet Sistemit Monetar Evropian, i cili ekzistoi nga viti 1979 deri në 1999. Ai kishte tre përbërës: ECU – shporta e monedhave të vendeve anëtare; mekanizimin e kursit të këmbimit dhe të ndërhyrjes, i cili i jepte çdo monedhe një vlerë qendrore të lidhur me ECU (kurs bilateral këmbimi) dhe mekanizimin e kredisë, i cili i lejonte bankat qendrore të ndërhynin, nëse kursi bilateral i këmbimit kalonte pragun e përcaktuar. Më 1 janar 1999, Sistemi Monetar Evropian u zëvendësua nga Mekanizmi i Kursit të Këmbimit.

**Stabiliteti i çmimeve:** është objektivi parësor i Eurosistemit. Stabiliteti i çmimeve është përcaktuar nga Këshilli Drejtues i Bankës Qendrore si rritja vjetore prej më pak se 2 % e nivelit të çmimeve të konsumit (e matur nga IHÇK). Për të arritur stabilitetin e çmimeve, Këshilli Drejtues synon të ruajë normat e inflacionit në nivele të ulëta, por afër 2% në afatin e mesëm.

**TARGET 2 (Sistemi Automatik TransEvropian i Transfertave në Kohë Reale):** sistem pagesash i cili përdoret për shlyerjen e operacioneve të bankave qendrore, të transfertave ndërbankare me vlerë të madhe në monedhën euro si dhe të pagesave të tjera në këtë monedhë. Ky sistem siguron shlyerjen në bankën qendrore dhe te klienti përfundimtar në kohë reale. Ai është i disponueshëm për transaksionet në euro brenda dhe midis vendeve anëtare të Eurozonës dhe vendeve të Bashkimit Evropian. TARGET 2 ka zëvendësuar sistemin TARGET të gjeneratës së parë, i cili filloi veprimet në janar të 1999, në kohën e kalimit në euro.

**Traktati:** i referohet Traktatit themelues të Komunitetit Evropian. Traktati origjinal u nënshkrua në Romë më 25 mars 1957 dhe hyri në fuqi më 11 janar 1958. Ky traktat themeloi Komunitetin Ekonomik Evropian (KEE), që sot njihet me emrin Komuniteti Evropian, (KE) dhe shpesh citohet si Traktati i Romës.

**Traktati i Amsterdimit:** u nënshkrua në Amsterdam më 2 tetor 1997 dhe hyri në fuqi më 1 maj 1999. Së bashku me Traktatin e Nicës që u nënshkrua më 26 shkurt 2001 dhe hyri në fuqi më 1 shkurt 2003, amenduan njëkohësisht traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe traktatin themelues të Bashkimit Evropian.

**Traktati i Bashkimit Evropian** (shpesh referohet si Traktati i Mastrihtit) u nënshkrua më 7 shkurt 1992 dhe hyri në fuqi më 1 nëntor

1993. Traktati i Bashkimit Evropian amendoi traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe themeloi Bashkimin Evropian.

**Traktati i Lisbonës:** u nënshkrua më 13 dhjetor 2007 dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009. Ai amendoi njëkohësisht traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe traktatin e Bashkimit Evropian. Traktati Lisbonës thjeshton strukturën e Bashkimit Evropian, e cila aktualisht përbëhet nga tre "shtylla": komuniteti, politika e jashtme dhe e sigurisë së përbashkët, drejtësia dhe punët e brendshme. Me traktatin e ri, tre shtyllat pushojnë së ekzistuari dhe Komuniteti zëvendësohet nga Bashkimi, i cili vishet me personalitet juridik. Traktati që themeloi Komunitetin Evropian është riuqajtur Traktati për Funksionimin e Bashkimit.

**Tregu i aksioneve:** është tregu i aksioneve të kompanive të listuara në bursë. Aksionet, zakonisht, konsiderohen si forma investimi me rrezik më të lartë sesa titujt, duke qenë se mbajtësit e aksioneve kanë të drejtën të marrin dividendë, nëse këta shpërndahen nga kompania përkatëse, ndërsa mbajtësit e titujve kanë të drejtë të marrin një interes pavarësisht fitimit të kompanisë përkatëse.

**Tregu i obligacioneve:** Kompanitë dhe qeveritë emetojnë obligacione për të financuar investimet e tyre. Obligacionet janë tituj kredie, pra letra me vlerë që mbartin interes me një normë fikse ose me një normë të ndryshueshme dhe kanë një maturim të paktën njëvjeçar (nga data e lëshimit). Obligacionet me normë fikse interesi përbëjnë pjesën më të madhe të këtij tregu.

**Tregu ndërbankar i parasë:** është tregu i huave afatshkurtra midis bankave. Ky term zakonisht përshkruan tregtimin e fondeve me një afat kohor nga një ditë (brenda natës ose më pak se një ditë) deri në një vit.

**Zona e Vetme e Pagesave në Euro (ZVPE) (SEPA - the Single Euro Payments Area):** është një zonë në Evropë ku individët, kompanitë dhe organizata të tjera mund të kryejnë dhe përfitojnë pagesa jo-cash në monedhën euro, brenda dhe jashtë kufijve kombëtarë, nën të njëjtat kushte, të drejta dhe detyrime, pavarësisht vendndodhjes së tyre. ZVPE funksionon si një treg i vetëm dhe i brendshëm pagesash, duke bërë të mundur që klientët të kryejnë pagesat e tyre më lehtë dhe me më pak kosto, si në qytetin e tyre. Nisma e ZVPE-s drejtohet nga Këshilli Evropian i Pagesave, themeluar në vitin 2002. Ai përbën entin vendimmarrës dhe koordinues të industrisë

bankare evropiane për pagesat.

E drejta e autorit e kësaj broshure i përket Bankës Qendrore Evropiane.  
Versioni shqip është përkthyer nga Banka e Shqipërisë, ndërkohë që  
versioni anglisht është versioni origjinal i saj. Broshura përditësohet  
rregullisht dhe versioni më i fundit i saj mund të merret falas në linkun:

<http://www.ecb.europa.eu/pub/html/index.en.html>

© European Central Bank, 2011

ADDRESS

Kaiserstrasse 29  
60311 Frankfurt am Main, Germany

POSTAL ADDRESS

Postfach 16 03 19  
60066 Frankfurt am Main, Germany

TELEPHONE

+ 49 69 1344 0

WEBSITE

<http://www.ecb.europa.eu>

FAX

+ 49 69 1344 6000

CONCEPT AND DESIGN

Konzept Verlagsgesellschaft, Frankfurt am Main, Germany

PHOTOGRAPHS

Claudio Hils  
Martin Joppen  
Martin Starl  
Marcus Thelen  
Andreas Varnhorn  
Walter Vorjohann  
European Community

PRINTED BY

Imprimerie Centrale s.a., Luxembourg

ISBN 978-92-899-0759-0 (online)

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonti në adresën:

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Avni Rustemi" Nr.24, Tiranë, Shqipëri.

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11

Faks: + 355 4 2419408.

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

[public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

Tirazhi: 7000 kopje